



Nr 1435 Prot

Tiranë, më 20/09/2019

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

*ndërmjet*

**KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
*dhe*

**QENDRËS FOKUS**

### Hyrje

Kjo marrëveshje rregullon bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD, në vazhdim) dhe Qendrës Fokus "Në ndihmë të fëmijëve" (FOKUS, në vazhdim) bëhet në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe përpjekjeve të përbashkëta për parandalimin dhe adresimin e qasjeve diskriminuese, fuqizimin e konceptit të gjithëpërfshirjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Ligjin "Për mbrojtjen nga Diskriminimi" si dhe legjislacioni në fuqi të ratifikuar nga Shqipëri për mbrojtjen dhe garantimin e grupeve të marginalizuara.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hartohet në gjuhën shqipe dhe do të jetë në fuqi në përputhje me dëshirën e shprehur të palëve.

### Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është mbështetja dhe bashkëkoordinimi i veprimitarive ndërgjegjësuese, fushatave sensibilizuese dhe promovimit të praktikave të mira në kuadër të mbështetjes së grupeve të marginalizuara (përfshi personat që vuajnë sëmundje mendore kronike apo çrregullime të shëndetit mendor, fëmijët në situatë rruge apo në rrezik trafikimi, gratë viktima të dhunë në familje në Tiranë, Elbasan, Shkodër, Fier dhe Vlorë (bashki/ qytete në të cilat ndodhen zyrat përkatëse të KMD).

### Objektivat specifike

Kjo marrëveshje do të garantojë bashkëveprim në (a) monitorimin e rasteve për të cilat kërkohet ndërhyrje nëpërmjet këtij partneriteti, (b) ndërmarrjen e fushatave të përbashkëta ndërgjegjësuese për qëllim parandalimin e diskriminimit ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë shqiptare; (c) advokimin për ndryshime ligjore dhe strukturore/ institucionale që garantojnë gjithëpërfshirje



si dhe (d) promovimin e praktikave të mira për konsolidimin institucional të KMD dhe replikimin e tyre me aktorë të shoqërisë civile..

Kjo marrëveshje do të krijojë mundësi konkrete për analizimin e praktikave të deritanishme administrative dhe institucionale në fushën e shërbimeve mjekësore, edukuese dhe mbrojtjes sociale për mirëfunkcionimin e këtyre shërbimeve në popullatën e prekur.

### **Angazhimi i përbashkët**

Në reflektim të Objektivave specifikë, angazhimi i përbashkët për zbatimin e kësaj marrëveshjeje nënkuption:

- monitorime dhe takime të përbashkëta me institucionet psikiatrike dhe shërbimet e kujdesit social për ofrimit e shërbimeve mjekësore dhe sociale nëpërmjet vlerësimit të nevojave të ndërhyrjes, mekanizmave vendorë dhe përgatitjes së tipologjisë së rasteve.
- Përgatitja e një raporti paraprak vleresues për monitorimin e gjendjes aktuale të ofrimit të shërbimeve, si një mjet advokimi për të pasur një shërbim mjekësor dhe social të aksesueshëm edhe për fëmijët kujdestarë të prindërve me probleme mendore.
- Përgatitja e materialeve advokuese në ndihmë të fëmijëve, për llojet e shërbimeve, format e përfitimit dhe organizmat që duhen kontaktuar rast pas rasti, si një mjet advokimi për të siguruar mbulimin e shërbimit.
- Realizimi i aktiviteteve advokuese me përfaqësues të autoriteteteve vendore, shkollave dhe institucioneve, për të advokuar për praktika të mira dhe ndryshim të qëndrueshëm.

### **Periudha e Marrëveshjes**

Kjo marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe dhe do të jetë në fuqi për një afat 3-vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim dhe me marrëveshje reciproke të palëve.

### **Përfundimi i marrëveshjes**

Kjo marrëveshje përfundon në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë dokument. Në rast se palët nënshkruese e ndryshojnë këtë afat, atëherë zbatohet afati i dytë i dakordësuar me shkrim ndërmjet palëve nënshkruese.

### **Hyrja në fuqi**

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e autorizuar të institucioneve palë. Nëse palët bien dakord dhe kërkojnë një ndryshim, ky ndryshim do të bëhet pas miratimit me shkrim dhe njoftimit përkatës zyrtar.

## **NËNSHKRIMI**



**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DRISKRIMINIM**

Z. Robert Gajda

Data: 20/09/2019



**QENDRA FOKUS  
“NË NDIHMË TË FËMIJËVE”**

Alba  
**Dr. Anita PILIKA, Kryetare**

Data: \_\_/09/2019